

B A N K A E S H Q I P Ë R I S Ë

B U L E T I N I Z Y R T A R

V Ë L L I M I 7, N U M R I 13, T E T O R 2005

Data e botimit 21.10.2005

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 77, datë 12.10.2005 “Për miratimin e raportit të Politikës Monetare për muajin gusht të vitit 2005” 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 12.10.2005 “Për miratimin e përmbajtjes dhe konfigurimeve të vizatimeve të monedhës që do të shtypet për qëllime numizmatike në vitin 2006” 26
3. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 1, Shkurt 2005 28
4. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 2, Shkurt 2005 28
5. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 3, Shkurt 2005 28
6. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 4, Prill 2005 28
7. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 5, Prill 2005 28
8. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 6, Maj 2005 29
9. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 7, Maj 2005 29
10. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 8, Qershor 2005 29
11. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 9, Qershor 2005 29
12. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 10, Korrik 2005 29
13. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 11, Gusht 2005 29
14. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 12, Shtator 2005 29



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

NR.77, DATË 12.10.2005

PËR

MIRATIMIN E "RAPORTIT TË POLITIKËS MONETARE PËR MUAJIN GUSHT
TË VITIT 2005"

Në mbështetje të nenit 43, shkronja "ç" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Të miratojë "Raportin e Politikës Monetare për muajin gusht të vitit 2005", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
YLLI MEMISHA

KRYETARI
ARDIAN FULLANI

BANKA E SHQIPËRISË

RAPORTI I POLITIKËS MONETARE

PËR MUAJIN GUSHT 2005

TETOR 2005

I. Zhvillimet kryesore të muajit

- Inflacioni vjetor shënoi një rritje të lehtë në muajin gusht, duke u rikthyer brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Norma vjetore dhe ajo mujore e inflacionit ishin përkatësisht 2.3 për qind dhe 0.2 për qind.
- Faktori kryesor i cili ka ndikuar inflacionin në muajin gusht është ecuria e çmimeve të grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji". Kontributi i grupit "Ushqime dhe pije joalkolike" në inflacionin e këtij muaji ka qenë në nivele minimale.
- Grupet e tjera të shportës së konsumit kontribuan me të njëjtën vlerë të muajit të kaluar, 0.5 pikë përqindjeje.
- Rritja e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar është shoqëruar me një rritje të moderuar të çmimit të këtij produkti në tregun vendas. Mbiçmimi i vazhdueshëm i lekut ndaj dollarit amerikan ka penguar përcjelljen e plotë të saj në vend.
- Zhvillimet e favorshme në kursin e këmbimit kanë bërë të mundur mbajtjen nën kontroll të presioneve inflacioniste të importuara. Në terma vjetorë, leku është mbiçmuar me rreth 2.4 për qind ndaj dollarit amerikan dhe 3.3 për qind ndaj euros në muajin gusht.
- Faktorët e kërkesës dhe ofertës vazhdojnë të japin një ndikim të ekuilibruar në ecurinë e çmimeve të konsumit. Respektimi i parametrave të përgjithshëm të programit buxhetor dhe atij monetar kanë krijuar kushte të favorshme makroekonomike për mbajtjen e inflacionit nën kontroll.
- Duke qëndruar përgjithësisht brenda kornizës së buxhetit vjetor të miratuar, politika fiskale nuk ka përcjellë presione të tepërta inflacioniste në ekonomi. Gjithsesi, përqëndrimi i huamarrjes buxhetore gjatë tre muajve të fundit ka krijuar probleme likuiditeti në sistem, duke rritur edhe luhatshmërinë e normave të interesit.
- Muaji korrik është karakterizuar nga një rritje më e ngadaltë e ofertës monetare, çka është reflektuar në rënien e ritmit vjetor të agregatit M3 në 16.0 për qind, nga 18.3 që ishte në muajin e kaluar. Ky ngadalësim është pasqyruar si në komponentin valutor ashtu edhe në atë në lekë të ofertës monetare.
- Muaji korrik ka njohur thellim të deficitit fiskal në nivelin 10.8 miliardë lekë ose 4 miliardë lekë më shumë se një muaj më parë. Deficiti fiskal është përballuar kryesisht nëpërmjet reduktimit të depozitës së qeverisë në masën 2.5 miliardë lekë, ndërkohë që huamarrja e re ka qenë në nivelin 1.5 miliardë lekë.
- Muaji korrik shënoi rritje mujore të tepricës së kredisë me 1.8 miliardë lekë duke arritur në 97.7 miliardë lekë. Në terma të PBB-së teprica e kredisë arriti në nivelin 11.4 për qind duke shënuar një rritje prej 2.4 pikë përqindje nga fundi i vitit 2004. Teprica e kredisë ka shënuar rritje vjetore prej 37.8 miliardë lekësh ose 62.8 për qind, duke qëndruar në nivele të larta gjatë gjithë vitit 2005.
- Sistemi bankar është karakterizuar nga një rënie e likuiditetit gjatë stinës së verës, si pasojë e rritjes së shpenzimeve konsumatore, e kredisë në lekë për ekonominë dhe e huamarrjes së brendshme të qeverisë.

II. Ecuria e inflacionit në muajin gusht.

Inflacioni vjetor shënoi një rritje të lehtë në muajin gusht, duke u rikthyer brenda objektivit

¹ Inflacioni mesatar vjetor është vlera mesatare e inflacionit vjetor të 12 muajve të fundit, përfshirë edhe muajin që analizohet.


të Bankës së Shqipërisë. Norma vjetore dhe ajo mujore e inflacionit ishin përkatësisht 2.3 për qind dhe 0.2 për qind. Ndërkohë, inflacioni mesatar vjetor¹ nuk pësoi ndryshime gjatë këtij muaji, duke qëndruar në vlerën 2.1 për qind.

TABELË 1. Norma vjetore e inflacionit (në për qind).

	2001	2002	2003	2004	2005
Janar	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3
Shkurt	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8
Mars	2.9	7.5	1.3	4.0	1.6
Prill	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3
Maj	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0
Qershor	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9
Korrik	5.6	4.2	3.0	3.1	1.8
Gusht	4.1	5.5	3.0	2.7	2.3
Shtator	3.5	5.3	2.8	2.0	
Tetor	1.8	5.8	2.9	2.0	
Nëntor	2.8	3.7	3.4	2.2	
Dhjetor	3.5	1.7	3.3	2.2	
Mesatar	3.1	5.2	2.2	3.0	2.1

Burimi: INSTAT

Grafik 1. Inflacioni vjetor në për qind.




II.1 Ecuria e inflacionit dhe e grupeve përbërëse.

Faktori kryesor i cili ka ndikuar inflacionin në muajin gusht është ecuria e çmimeve të grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”. Kontributi i këtij grupi në normën vjetore të inflacionit në muajin gusht, ishte 1.8 pikë përqindjeje ndërkohë që kontributi i grupit

“Ushqime dhe pije joalkolike” në inflacionin e këtij muaji ka qenë në nivele minimale. Grupet e tjera të shportës së konsumit kontribuan me të njëjtën vlerë të muajit të kaluar, 0.5 pikë përqindjeje.

Grafik 2. Kontributi i grupeve kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Pas një vlere të theksuar negative në muajin korrik, inflacioni vjetor i grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” paraqiti një nivel afër zeros në muajin gusht. Rritja e inflacionit të këtij grupi në muajin gusht, shpjegohet me sezonin më të gjatë turistik të këtij viti, i cili çoi në rritjen e kërkesës për mallrat ushqimorë në një kohë që tregu vendas arrin pikun e ofertës në muajin korrik. Niveli i çmimeve të këtij grupi, edhe këtë muaj, u kushtëzua nga ecuria e çmimeve të produkteve bujqësore². Nga ana tjetër, rritja e importeve të këtyre produkteve gjatë këtij muaji nuk solli presione të forta inflacioniste tek çmimet e tyre. Kjo, sepse kursi i këmbimit të lekut ndaj euros ka qenë relativisht i qëndrueshëm dhe çmimet e mallrave ushqimorë në vendet partnere si Italia dhe Greqia, vazhdojnë të qëndrojnë në nivele brenda luhatjeve normale sezonale.

Tabelë 2. Norma vjetore e inflacionit të grupit “Ushqime dhe pije joalkolike” (në vend dhe jashtë) si dhe kontributi i inflacionit të këtij grupi në inflacionin total.

	Inflacioni vjetor'04	Kontributi (pp)	Inflacioni vjetor'05	Kontributi (pp)	Itali ² Inflacioni vjetor'05	Greq ⁴ Inflacioni vjetor'05
Janor	3.2	1.4	-0.7	-0.3	-0.7	0.6
Shkurt	2.7	1.2	-1.2	-0.5	-0.4	-0.9
Mars	2.3	1.0	-1.7	-0.7	-0.2	-1.4
Prill	0.1	0.1	-2.3	-1.0	-0.2	-0.1
Maj	-1.1	-0.5	-0.7	-0.3	-0.2	-0.4
Qershor	-0.7	-0.3	1.6	0.7	-0.2	-0.5
Korrik	-0.1	0.0	-1.6	-0.7	-0.2	0.7
Gusht	-1.4	-0.6	0.0	0.0	-0.2	1.4

² Çmimet e frutave u ulën në 10.3 për qind, kurse çmimet e perimeve u rritën me 2.9 për qind.


³ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>

⁴ Burimi: General Secretariat of National Statistical Service of Greece; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>

Kontributi i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” është ulur përsëri në nivelet e tremujorit të parë të këtij viti, pas rritjes që pësoi në muajin korrik. Në muajin gusht, inflacioni vjetor i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse, energji” shënoi një vlerë prej 6.9 për qind, nga 7.7 për qind që ishte një muaj më parë. Në këtë shifër ka ndikuar rënia e çmimit të qirasë dhe rentës së imputur në nivelet mesatare të tremujorit të dytë prej 2.2 për qind, pas rritjes që pësoi në korrik si rezultat i periudhës së sezonit më intensiv turistik.

Çmimet e tjera të administruara si tarifatat shëndetësore dhe arsimore, kanë vazhduar rritjen edhe gjatë këtij muaji. Kontributi i tyre në normën e përgjithshme të inflacionit vazhdon të jetë i pandjeshëm, si rrjedhojë e peshës së vogël⁵ që ato kanë në shportën e konsumit. Rritja e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar është reflektuar edhe në tregun e brendshëm të karburanteve. Si rezultat, grupi “Transport” ka pësuar rritjen më të lartë që prej gushtit të vitit të kaluar, ndërsa nëngrupi “Shërbime ndaj mjeteve personale”⁶ është rritur me 10.3 për qind. Inflacioni i grupeve të tjera të shportës ka ndikuar pak në përcaktimin e normës së inflacionit, edhe për faktin se lëvizjet e çmimeve në to kanë qenë brenda luhatjeve të zakonshme sezonale.

Grafik 3. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në për qind).



II.2 Ambienti makroekonomik dhe çmimet e konsumit

Zhvillimet makroekonomike dëshmojnë për një mjedis të qëndrueshëm makroekonomik. Inflacioni vjetor (2.3 për qind) dhe inflacioni mesatar vjetor (2.1 për qind) në muajin gusht 2005 qëndruan brenda objektivit 2-4 për qind. Faktorët e kërkesës dhe ofertës vazhdojnë të japin një ndikim të ekuilibruar në ecurinë e çmimeve në vend. Respektimi i parametrave të përgjithshëm të programit buxhetor dhe atij monetar, si dhe ecuria e kursit të këmbimit, kanë krijuar një klimë të favorshme makroekonomike për mbajtjen e inflacionit nën kontroll. Politika fiskale


Duke qëndruar përgjithësisht brenda kornizës së buxhetit vjetor të miratuar, politika fiskale nuk ka përcjellë presione të tepërta inflacioniste në ekonomi. Gjithsesi, përqëndrimi i

⁵ Përkatësisht grupet zënë një peshë prej 2.1 dhe 1.0 për qind në shportën e konsumit.

⁶ Inflacioni vjetor i këtij nëngrupi për muajt qershor dhe korrik '05 është përkatësisht 6.2 dhe 8.8 për qind.

huamarrjes buxhetore gjatë tre muajve të fundit ka krijuar probleme likuiditeti në sistem, duke rritur edhe luhatshmërinë e normave të interesit. Megjithëse periudha janar – korrik është karakterizuar nga rritje të shpenzimeve buxhetore, korente dhe kapitale, shpenzimet totale kanë qenë brenda kufirit të programuar. Në muajin korrik, të ardhurat totale arritën në masën 92.8 për qind të planit ndërsa shpenzimet totale buxhetore u realizuan në masën 96.4 për qind. Deficiti buxhetor tejkaloi me 10.8 pikë përqindjeje nivelin e programuar. Realizimi i programuar i shpenzimeve korente si dhe financimi i matur i deficitit buxhetor nuk kanë rrezikuar normën e inflacionit.


Grafik 4. Norma vjetore e inflacionit (boshti majtas) dhe rritja vjetore e shpenzimeve buxhetore (boshti djathtas).



Politika monetare.

Politika lehtësuese e Bankës së Shqipërisë ka përmbushur mirë nevojat e ekonomisë për mjete monetare, duke mos ushtruar presione inflacioniste. Normat e ulta të interesit kanë siguruar kosto më të ulta huamarrjeje, duke nxitur rritjen e kreditimit të ekonomisë. Nga ana tjetër, në një mjedis me norma të ulta inflacioni, interesi real pozitiv ka arritur të kanalizojë fondet e lira të ekonomisë në sistemin bankar, duke mos krijuar tepriçë likuiditeti.

Grafik 5. Norma vjetore e inflacionit dhe rritja vjetore e interesit real.



Të dy komponentët kryesorë të politikës makroekonomike kanë krijuar kushte për rritje të moderuar të normës së inflacionit në vend.

Kursi i këmbimit dhe inflacioni i importuar.

Zhvillimet e favorshme në kursin e këmbimit kanë bërë të mundur mbajtjen nën kontroll të presioneve inflacioniste të importuara. Në terma vjetorë, leku është mbiçmuar me rreth

2.4 për qind ndaj dollarit amerikan dhe 3.3 për qind ndaj euros në muajin gusht. Ndërsa gjatë muajve të fundit dy partnerët kryesorë tregtarë të vendit tonë kanë njohur rritje të lehtë të inflacionit në vend, mbiçmimi i vazhdueshëm i lekut ndaj euros ka zbutur presionet inflacioniste që mund të përçoheshin nga inflacioni i importuar.


Tabelë 3. Ndryshimet vjetore në inflacionin e vendeve partnere dhe në kursin e këmbimit (në përqindje).

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht
Greqi ⁷	4.0	3.1	2.9	3.4	3.2	3.3	3.9	3.7
Itali ⁸	1.9	1.9	1.9	1.9	1.9	1.8	2.1	2.0
Lek/Euro	-5.3	-4.8	-3.1	-1.6	-2.3	-1.0	-1.8	-2.4
Lek/Usd	-8.8	-7.4	-9.8	-8.9	-7.4	-1.2	0.0	-3.3

Çmimi i naftës.

Rritja e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar është shoqëruar nga rritje të moderuara të çmimit të këtij produkti në tregun vendas. Ndërsa, të dhënat e tregut ndërkombëtar⁹, për muajin gusht flasin për një rritje vjetore prej 63.7 për qind në çmimin naftës, kjo rritje në tregun e brendshëm është vetëm 29.6 për qind. Mbiçmimi i vazhdueshëm i lekut ndaj dollarit amerikan ka penguar përcjelljen e plotë të kësaj rritjeje në vend. Akoma më i zbehtë është ndikimi i këtij faktori në ecurinë e inflacionit, të matur nga Indeksi i Çmimeve të Konsumit. Ashtu siç është përmendur dhe në raportet e mëparshme, pesha e vogël që zë ky produkt në shportën e IÇK-së, bën që rritja e çmimit të naftës në vend të mos pasqyrohet e plotë. Kështu, rritja vjetore prej 29.6 për qind e çmimit të naftës në vend u reflektua pjesërisht në rritjen e inflacionit të grupit "Transport" në 4.7 për qind, që shtoi me 0.23 pikë përqindjeje shifrën totale të inflacionit.

Grafik 6. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në vend, në tregun ndërkombëtar dhe i kursit të këmbimit (në përqindje).



Harmonizimi i mirë i politikës fiskale me atë monetare, mbiçmimi i vazhdueshëm i lekut, si dhe efekti i zbutur i *shock*-ut të rritjes së çmimit të naftës kanë ndihmuar në kontrollin e

⁷ Burimi: General Secretariat of National Statistical Service of Greece; faqja e internetit: <http://www.statistics.gr>

⁸ Burimi: ISTAT; faqja e internetit <http://www.istat.it>

⁹ Burimi: Bloomberg.

presioneve inflacioniste dhe në krijimin e një ambienti të përshtatshëm për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve edhe gjatë periudhës në vazhdim.

I. Politika monetare dhe treguesit monetarë

I.1.1 Politika monetare e Bankës së Shqipërisë

Situata monetare e tremujorit të tretë shënoi një devijim të dukshëm nga ecuria historike dhe parashikimet tona. Në ndryshim nga 2-3 vitet e shkuara, kjo periudhë u karakterizua nga një dalje e ndjeshme *cash*-i në qarkullim, nga përqendrimi i huamarrjes së brendshme të qeverisë dhe nga një përkeqësim i situatës së likuiditetit të sistemit bankar. Për më tepër, presionet sezonale mbiçmuese të kursit të këmbimit të lekut, të pranishme në stinën e verës si pasojë e prurjeve të mëdha të emigrantëve, nuk u shfaqën në kohën dhe në intensitetin e pritur.

Kjo situatë kërkoi një vëmendje më të madhe për ruajtjen e ekuilibrave monetarë. Në planin operacional, Banka e Shqipërisë synoi administrimin e situatës së likuiditetit dhe rishqyrtimin e planit të operacioneve valutore, në funksion të rivendosjes së likuiditetit në sistem dhe të ruajtjes së kursit të këmbimit. Banka e Shqipërisë ndërroi kahun e operacioneve të saj të likuiditetit, duke furnizuar sistemin bankar me likuiditet nëpërmjet marrëveshjeve të ansjellta të riblerjes si dhe ka financuar në periudha afatshkurtra deficitin buxhetor, për të shmangur luhatjet e mëdha të interesit në tregun ndërbankar dhe atë të bonove të thesarit.

Kjo politikë ka ndikuar në qetësimin e situatës së likuiditetit dhe në frenimin e presioneve rritëse mbi *yield*-in e bonove të thesarit, ndërkohë që situata e inflacionit mbetet nën kontroll. Megjithatë, shmangia nga kursi i parashikuar i treguesve monetarë ka bërë që objektivat e mjeteve të brendshme neto dhe të rezervës ndërkombëtare neto të rezutojnë të shkelur. Duke e konsideruar këtë një shkelje të përkohshme, Banka e Shqipërisë vlerëson se ekuilibrat monetarë dhe perspektiva e çmimeve të konsumit mbeten nën kontroll.

Tabelë 4. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.


	Dhjetor '04	Mars '05	Maj '05	Qershor '05	Korrik '05	Gusht '05*
Rezervat Ndërkombëtare Neto (milione dollarë)						
Objektivi	942	1,073	1,082	1,087	1117	1148
Aktuale	1,105	1,107	1,104	1,098	1105	1103
Diferenca	163	35	23	11	-12	-45
Mjetet e Brendshme Neto (miliardë lekë)						
Objektivi	79	61	60	60	60	59
Aktuale	61	53	57	64	65	66
Diferenca	-18	-8	-3	4	5	7
Kredia e Brendshme Neto për Qeverinë (miliardë lekë)						
Objektivi	286	292	296	298	299	
Aktuale	285	288	291	294	298	
Diferenca	-1	-4	-5	-4	-1	

*Të dhëna operative.

III.2 Agregatët monetarë

Muaji korrik është karakterizuar nga një rritje më e ngadaltë e ofertës monetare, çka është reflektuar në rënien e ritmit vjetor të agregatit M3 në 16.0 për qind, nga 18.3 që ishte në muajin e kaluar. Ky ngadalësim është pasqyruar si në komponentin valutor ashtu edhe në atë në lekë të ofertës monetare. Mbiçmimi i lekut në muajin korrik ka ndikuar negativisht rritjen e depozitave në valutë të shprehura në lekë, ndërkohë që edhe rritja vjetore e agregatit M2 ka shfaqur rënie të ndjeshme. Ndryshe nga viti i kaluar, flukset hyrëse valutore nuk kanë kontribuar në rritjen e ofertës monetare në lekë, duke bërë që ritmi vjetor i agregatit M2 të zbrësë drejt vlerave të tij historike¹⁰. Në përputhje me prirjen sezonale, struktura kohore e ofertës monetare ka njohur rritjen e mëtejshme të peshës së komponentit të saj më likuid.

Grafik 7. Ecuria e normave vjetore të agregatëve monetarë.




Depozitat në valutë kanë dhënë një kontribut të ulët në rritjen e ofertës monetare në muajin korrik. Niveli i tyre shënoi një rritje mujore prej 0.3 miliardë lekësh ose rreth 0.2 për qind, duke reflektuar efektin negativ të mbiçmimit mujor të lekut (rreth 3 miliardë lekë). Norma e rritjes vjetore të depozitave në valutë ka pësuar gjithashtu rënie në 25.6 për qind, nga 30.2 për qind që ishte një muaj më parë. Në mungesë të efektit vjetor të kursit këmbimit, norma e rritjes vjetore të depozitave në valutë paraqitet në nivele të larta dhe të qëndrueshme, rreth 29.5 për qind. Megjithëse flukset valutore kanë qenë nën nivelin e verës së vitit të kaluar, reduktimi i diferencës midis normave të interesit në lekë dhe në valutë ka nxitur vendosjen e një pjese më të madhe të këtyre flukseve në mjete monetare në valutë, duke ruajtur ritme të larta vjetore të depozitave valutore. Struktura e depozitave në valutë sipas afateve ka njohur rritjen e ndjeshme të peshës së depozitave me afat. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i zhvendosjes së depozitave të sektorit privat në një nga bankat e sistemit, nga llogari rrjedhëse në depozita me afat, për një shumë prej afërsisht 1.9 miliardë lekësh.

¹⁰ Agregati M2 shënoi një rritje të dukshme gjatë muajve korrik dhe gusht të vitit të kaluar, si rezultat i flukseve mjaft të larta valutore që pasuan zhvillimin e Lojërave Olimpikë në Greqi dhe normave më të larta të interesit në lekë kundrejt atyre në valutë, të cilat i orientuan këto flukse drejt mjeteve monetare në lekë.

Ngadalësimi i rritjes së agregatit M2 është reflektuar në ritme më të ulëta rritjeje të treguesve të parasë jashtë bankave dhe të depozitave në lekë. Pas rritjes së ndjeshme të saj në muajin e kaluar, paraja jashtë bankave i është rikthyer ritmeve normale të rritjes. Në përputhje me ecurinë sezonale, niveli i saj ka shënuar një rritje mujore prej 2.5 miliardë lekësh ose 1.8 për qind. Ndërkohë norma e rritjes vjetore të këtij treguesi në muajin korrik ka pësuar rënie të ndjeshme, duke shënuar vlerën 11.4 për qind, nga 14.9 për qind që ishte në muajin qershor.

Raporti i parasë jashtë bankave ndaj agregatit M3, në muajin korrik, arriti në 25.4 për qind, nga 25.1 për qind që ishte në muajin e kaluar. Rënia e normave reale të interesit në nivelet minimale historike, nuk duket të ketë ndikuar në rritjen e këtij treguesi përtej efekteve të njohura sezonale. Gjithashtu, ecuria normale e raportit të parasë jashtë bankave ndaj M3 tregon për shuarjen e ndikimit të disa prej faktorëve që shkaktuan rritjen e përkohshme të tij në muajin qershor.

Grafik 8. Raporti i PjB ndaj M3 dhe norma mesatare e interesit real të depozitave me afat në lekë (shkalla djathtas).



Kontributi i depozitave në lekë në rritjen mujore të ofertes monetare ka rezultuar gjithashtu në nivele të ulëta. Rritja mujore e depozitave në lekë shënoi rreth 0.7 miliardë lekë, ndërsa norma e rritjes vjetore të tyre zbriti nga 14.7 për qind në 14.1 për qind në muajin korrik. Kjo rënie ka reflektuar ngadalësimin e depozitave të sektorit privat, ndërkohë që edhe ritmi i rritjes vjetore të depozitave në lekë të individëve ka shënuar një rënie të lehtë. Ngadalësimi i depozitave në lekë është shenjë e rënies së atraktivitetit të tyre përballë alternativave të tjera të investimit (bono thesari dhe depozita në valutë), si pasojë e rënies së ndjeshme të normave të interesit në lekë gjatë muajve të fundit.


Si rezultat i ndryshimeve në klasifikimin e depozitave në lekë¹¹, depozitat pa fat në lekë kanë shënuar një rritje të ndjeshme prej 5.0 miliardë lekësh, kundrejt rënies prej 4.3 miliardë lekësh të depozitave me afat në lekë. Kjo rritje e depozitave pa afat në lekë ka zbehur efektin e ngadalësimit të parasë jashtë bankave në ecurinë e agregatit M1. Ritmi vjetor i rritjes së këtij agregati shënoi një rënie të lehtë në muajin korrik, duke zbritur në

¹¹ Politika e mosrinovimit të depozitave me afat në lekë të klientëve individë nga Banka Raiffeisen në përfundim të afatit të maturimit, ka shkaktuar riklasifikimin e tyre si depozita pa afat. Ndikimi i këtij riklasifikimi për muajin korrik është rreth 4.5 miliardë lekë.

25.1 për qind, nga 25.8 për qind që ishte në muajin qershor.

Struktura valutore e ofertës monetare ka mbetur pothuajse e pandryshuar nga muaji i kaluar. Nën ndikimin e efektit të ndjeshëm të kursit të këmbimit, raporti i depozitave në valutë ndaj agregatit M3 ka ndërprerë tendencën e tij rritëse, duke shënuar një rënie të lehtë në nivelin 25.0 për qind.

Grafik 9. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3.



Tabelë 5. Ecuria e treguesve monetarë në muajin korrik (në miliardë lekë).

	Korrik	Ndryshimi mujor		Ndryshimi vjetor	
	2005	Absolut	Përqindje	Absolut	Përqindje
Paraja jashtë bankave	138.3	2.5	1.8	14.2	11.4
Depozita totale	407.0	1.0	0.2	61.2	17.7
- në lekë	270.6	0.7	0.2	33.4	14.1
- në valutë	136.3	0.3	0.2	27.8	25.6
Depozita pa afat	93.9	3.4	3.7	27.2	40.7
- në lekë	46.0	5.0	12.2	22.8	98.4
- në valutë	47.9	-1.6	-3.2	4.4	10.0
Depozita me afat	313.1	-2.4	-0.8	34.0	12.2
- në lekë	224.6	-4.3	-1.9	10.6	5.0
- në valutë	88.4	1.9	2.2	23.4	36.0
M1	184.3	7.5	4.2	37.0	25.1
M2	408.9	3.1	0.8	47.6	13.2
M3	545.3	3.4	0.6	75.4	16.0
Baza monetare	182.3	1.8	1.0	21.0	13.0

III.2.1 Mjetet valutore neto

Rritja vjetore e mjeteve valutore neto në korrik dha një kontribut prej 21.1 për qind në rritjen vjetore të ofertës monetare, duke përbërë kontributin më të ulët të tyre që nga fillimi i vitit. Ritmi i rritjes së mjeteve valutore neto ka vazhduar të jetë i ulët edhe për muajin korrik, megjithëse në nivel absolut ato shënojnë një rritje prej 17.5 milionë usd krahasuar

me një muaj më parë. Duke përjashtuar efektin e kursit të këmbimit, rritja e këtyre mjeteve është 20.8 milionë usd.


Grafik 10. Kontributi i rritjes së mjeteve valutore neto në rritjen vjetore të M3.



Kontributin më të madh në rritjen e mjeteve valutore të sistemit e kanë dhënë mjetet valutore neto të bankave tregtare, me një rritje mujore prej 13.5 milionë usd. Gjatë muajit korrik, si depozitat ashtu dhe kreditë në valutë kanë shënuar rritje, por niveli i depozitimit në valutë ka qenë më i lartë duke krijuar hapësira për rritjen e mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë. E llogaritur me kursin fiks, rritja e këtyre mjeteve është 14.1 milionë usd.

Banka e Shqipërisë ka rritur rezervën valutore neto me 4.2 milionë usd. E llogaritur me kurs fiks, rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë është rritur me 6.7 milionë usd. Ky rezultat vjen nga rritja e depozitave në bankat e huaja si dhe nga ulja në zërin e detyrimeve ndaj FMN-së.

Grafik 11. Niveli i mjeteve valutore neto të sistemit bankar.




III.2.2 Kërkesa e qeverisë për mjete monetare

Muaji korrik ka njohur thellim të deficitit fiskal në nivelin 10.8 miliardë lekë ose 4 miliardë lekë më shumë se një muaj më parë. Deficiti fiskal është përballuar kryesisht nëpërmjet redukimit të depozitës së qeverisë në masën 2.5 miliardë lekë, ndërkohë që huamarrja e

re ka qenë në nivelin 1.5 miliardë lekë. Banka e Shqipërisë ka financuar përkohësisht deficitin në masën 1.5 miliardë lekë. Financimi i brendshëm mujor është siguruar nga emetimi i obligacioneve qeveritare dy dhe trevjeçare. Këtë muaj u emetuan 1.7 miliardë lekë obligacione dyvjeçare dhe rreth 2 miliardë lekë obligacione trevjeçare. Rritja e huamarrjes së brendshme prej 5.2 miliardë lekësh ka kompensuar uljen prej 3.7 miliardë lekësh të nivelit të bonove të thesarit të blera në tregun primar. Në muajin korrik, vihet re një rënie e portofolit të bonove të thesarit të bankave të nivelit të dytë me 4.4 miliardë lekë. Ulje në një masë të lehtë është vërejtur edhe në portofolin e institucioneve. Nga ana tjetër, individët dhe Banka e Shqipërisë kanë rritur lehtësisht portofolet e tyre të bonove të thesarit.

Grafik 12. Ecuria kumulative e financimit të deficitit buxhetor (në miliardë lekë).



III.2.3Kredia për ekonominë

Muaji korrik shënoi rritje mujore të tepricës së kredisë me 1.8 miliardë lekë duke arritur në 97.7 miliardë lekë. Në terma të PBB-së teprica e kredisë arriti në nivelin 11.4 për qind, duke shënuar një rritje prej 2.4 pikë përqindje nga fundi i vitit 2004.


Tabelë 6. Ecuria e disa treguesve kryesorë.

	2002	2003	2004	Maj '05	Qershor '05	Korrik '05
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	416.7	448.4	507.2	533.2	541.8	545.3
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	70.8	71.5	68.9	69.5%	69.9%	70.4%
- Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	61.5	60.2	55.1	52.8%	52.2%	52.4%
- Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	9.3	11.3	13.8	16.6%	17.7%	17.9%
Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve)	11.5	13.7	16.9	19.5%	20.8%	21.1%
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	5.7	6.8	9.0	10.4	11.2	11.4
Raporti kredi / depozita (në %)	13.5	15.7	19.0	22.0	23.6	24.0

Teprica e kredisë ka shënuar rritje vjetore prej 37.8 miliardë lekësh ose 62.8 për qind, duke qëndruar në nivele të larta gjatë gjithë vitit 2005. Kredia në lekë vazhdon të njohë

rritje; kontributi i saj ndaj rritjes vjetore të kredisë total nga 32 për qind që ishte në muajin qershor, arriti në 35 për qind. Gjatë muajit korrik rritja e kredisë në lekë mendohet të ketë marrë shtytje nga ecuria pozitive e kredisë për individët. Përshpejtimi i kredisë në lekë ka favorizuar edhe pozicionimin e saj ndaj kredisë në valutë, duke përbërë në fund të muajit korrik, 23.2 për qind të tepricës së kredisë në total.

Grafik 13. Rritja vjetore e kredisë sipas monedhës dhe në total.



Kredia sipas sektorëve ka dëshmuar një rritje të lehtë të kredisë për individët, e cila në fund të muajit korrik ishte rreth 30.7 miliardë lekë. Rreth 35 për qind e saj përbëhet nga kredia në lekë. Gjatë muajit korrik 2005, kredia për këtë grup u rrit me 1.5 miliardë lekë dhe vetëm kredia në lekë e këtij grupi ka shfaqur rritje prej 1 miliard lekësh. Rënia e peshës së kontributit të kredisë për sektorin privat mendohet të ketë ardhur si rezultat i shlyerjeve në nivele të larta të kredisë.

Tabelë 7. Tregues të tepricës së kredisë në përqindje ndaj totalit.

	2003	2004	T-1 '05	Qersh '05	Korrik '05
Teprica e kredisë (në mld lekë)	50.7	69.3	79.0	95.9	97.7
Kredi afatshkurtër	46.0	34.0	34.1	33.7	34.4
Kredi afatmesme	33.3	36.0	34.5	33.1	31.6
Kredi afatgjatë	20.7	30.0	31.4	33.1	33.8
Kredi për individët	24.5	30.6	31.0	30.8	31.4
Kredi për sektorin privat	75.5	69.4	69.0	69.2	68.6
Lekë	19.6	19.5	20.1	22.9	23.2
Valutë	80.4	80.5	79.9	77.1	76.8

Shpërndarja sektoriale e kredisë për muajin korrik, në përgjithësi ka mbetur e njëjtë me atë të muajit qershor. Sektori i tregtisë vazhdon të përbëjë sektorin kryesor, që tërheq pjesën më të madhe të kredisë për ekonominë. Gjithsesi gjatë vitit 2005 kredia për këtë sektor ka shfaqur tendenca rënëse, duke përbërë, në fund të muajit, rreth 19 për qind të portofolit të kredisë.

Tabelë 8. Ecuria e kredisë për degët më kryesore të ekonomisë.

	2002	2003	2004	T1 '05	T2 '05	Korrik '05
Bujqësia, Gjuetia dhe Silvikultura	0.8	1	1.5	1.5	1.5	1.5
Industria Përpunuese	17	17	17.1	16.7	15.6	15.1
Ndërtimi	8.6	10	9.8	11.2	11.2	11.2
Tregtia, Riparimi i Automobilitave dhe Artikujve Shtëpiake	40.4	34	23.3	20.6	19.1	19.1
Hotele dhe Restorante	6	6	8.3	5.2	4.7	4.7
Pasuritë e Patundëshme	9.1	13	9.8	14.7	13.5	13.4
Të tjera	18.1	19	30.2	30.1	34.3	35.1
Totali	100	100	100	100	100	100

Në muajin korrik janë akorduar gjithsej 10.2 miliardë lekë kredi e re ose 34 për qind më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Krahasuar me muajin qershor kredia e re akorduar pasqyron një rënie me 20 për qind, ndërkohë që mbetet në të njëjtat nivele me muajt më të mirë për pjesën e parë të vitit 2005. Kredia e re e akorduar kryesisht është dhënë për periudhë afatshkurtër (48 për qind) dhe në valutë (68 për qind). Gjithësesi krahasuar me një vit më parë vihet re një rënie e pjesës së kredisë afatshkurtër (61 për qind) si dhe rritje e peshës së kredisë në lekë ndaj totalit të kredisë së akorduar (30 për qind). Kjo kredi është akorduar në pjesën më të madhe për sektorin e tregtisë dhe për sektorët prodhues, si industria nxjerrëse dhe përpunuese, si dhe ndërtim. Gjithashtu, muaji korrik shënoi dhe një rritje të mëtejshme të kredisë së re për bujqësinë.

Tabelë 9. Tregues të kredisë së re në përqindje ndaj totalit.


	2004		2005		Qershor	Korrik
	Korrik	Dhjetor	Mars	Prill		
Kredia e re (në mld lekë)	7.6	11.0	8.5	10.4	9.5	12.6
Kredi afatshkurtër	60.7	56.4	51.3	50.3	39.8	49.9
Kredi afatmesme	21.5	23.4	24.3	28.0	37.8	28.3
Kredi afatgjatë	17.8	20.2	24.4	21.7	22.4	21.8
Lekë	30.1	26.7	28.7	26.2	33.4	37.9
Valutë	70.0	73.3	71.3	73.8	66.6	68.0

III.3 Tregjet dhe ecuria e normave të interesit

III.3.1 Ecuria e likuiditetit

Në muajin gusht, sistemi bankar është karakterizuar nga një rënie e theksuar e likuiditetit, e cila ka vazhduar dhe në fillim të muajit shtator. Mesatarisht, niveli ditor i likuiditetit në muajin gusht ra në 0.74 miliardë lekë nga 3.00 miliardë lekë një muaj më parë, dhe 4.71 miliardë lekë një vit më parë. Rënia e likuiditetit është shoqëruar me rritjen e parasë jashtë bankave në fund të muajit korrik dhe gjatë muajit gusht e shtator. Kjo lëvizje është ndikuar nga rritja e shpenzimeve konsumatore, e kredisë në lekë për ekonominë dhe e rritjes së huamarrjes për mbulimin e deficitit buxhetor gjatë kësaj periudhe.

Grafik 14. Niveli i likuiditetit të tepërt (në miliardë lekë).



Marrëveshjet repo me maturim njëjavor vijuan të përdoren për tërheqjen e likuiditetit të tepërt, në fillim të muajit gusht. Në kushtet e kërkesës për likuiditet nga sistemi bankar në pjesën e dytë të muajit, Banka e Shqipërisë organizoi ankande të marrëveshjeve të anasjellta repo me maturim njëjavor, duke injektuar në këtë mënyrë, mesatarisht 1.95 miliardë lekë. Niveli mesatar i depozitës njëditore zbriti nga 1.10 miliardë lekë në muajin korrik, në 0.39 miliardë lekë, ndërsa ai i rezervës së tepërt ra me 0.07 miliardë lekë, në vlerën 0.65 miliardë lekë. Përdorimi i kredisë njëditore mbeti në të njëjtat nivele si një muaj më parë dhe vlera mesatare e kredisë njëditore për muajin gusht, rezultoi 0.04 miliardë lekë.


Krahasuar me muajin e kaluar, tregu ndërbankar ka shfaqur rritje të vëllimit të transaksioneve gjatë muajit gusht. Huadhënia njëditore në këtë treg shënoi vlerën mesatare prej 0.96 miliardë lekësh, ose 0.29 miliardë më shumë se në muajin korrik. Vëllimi mesatar i transaksioneve njëditore u rrit në 1.00 miliard lekë nga 0.48 miliardë lekë.

Një pjesë e likuiditetit është investuar në tregun primar për financimin e deficitit buxhetor. Krahasuar me muajin korrik, në muajin gusht portofoli i bankave në letra me vlerë të qeverisë është rritur me 1.50 miliardë lekë.

III.3.2 Ecuria e normave të interesit

Ndryshe nga prirja e treguar në gjashtëmuajorin e parë të vitit, në muajt korrik dhe gusht, normat e interesit të lekut në tregje kanë shfaqur një prirje rritëse. Ndonëse politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka qenë e pandryshuar, normat e interesit për depozitat në lekë, tregun primar dhe atë ndërbankar janë ndikuar, në pjesën më të madhe, nga pakësimi i likuiditetit.

Grafik 15. Ecuria e normave të interesit.



*interesat e depozitave në lekë për muajin gusht, janë sipas të dhënave operative.

Interesi mesatar i ponderuar për depozitat 12-mujore në lekë u rrit në 4.06 për qind në muajin korrik nga 3.89 një muaj më parë (ose 2.33 pikë përqindjeje poshtë nivelit të një viti më parë). Ndikuar nga ulja e normës vjetore të inflacionit në muajin korrik, interesi real për këto depozita u rrit duke kapur nivelin 2.22 për qind, nga 0.96 për qind në muajin qershor.

Rritje e theksuar e interesave është vënë re edhe në tregun primar, ku *yield*-i i bonove të thesarit u ngrit nga 6.97 për qind në muajin korrik në 8.41 për qind në fund të muajit gusht (maturim 12-mujor). Mungesa e likuiditetit ka bërë që oferta e bankave për blerjen e bonove të thesarit të jetë e kufizuar, në disa raste dhe duke mos plotësuar shumën e emetuar. Konkurrenca në ankande është ulur duke ushtruar presion për rritje të *yield*-it. Nevoja për likuiditet, ka bërë që edhe në tregun ndërbankar, interesat për transaksionet të lëvizin nga 3.80 për qind në muajin korrik, në 5.79 për qind në muajin gusht (transaksione njëditore).

Tabelë 10. Ndryshimi i interesave të depozitave dhe kredive në lekë.

	Korrik -05	Ndryshimi vjetor korrik 05-korrik 04	Ndryshimi mujor korrik 05-qershor 05
Depozita në lekë			
1 mujore	3.20	- 0.69	+ 0.09
3 mujore	3.02	- 1.86	- 0.06
6 mujore	3.72	- 2.29	- 0.05
12 mujore	4.06	- 2.33	+ 0.17
Depozita 24 mujore	6.41	n/a	+ 1.80
Kredi në lekë			
- 6 muaj	13.30	+ 1.07	+ 2.68
6 - 12 muaj	12.00	- 6.33	+ 0.39
1-3 vjet	15.95	- 5.17	- 0.71
+ 3 vjet	11.77	- 3.60	- 0.59


Interesat mesatarë të ponderuar për kreditë e dhëna në lekë në muajin korrik, kanë patur tendencë të rriten për afatet nën një vit dhe janë ulur për kreditë mbi një vit. Ata janë ndikuar nga prirja në rritje e interesave të depozitave në lekë, nga rritja e *yield*-it të bonove të thesarit, por dhe nga ndryshimi i strukturës së kredidhënies sipas bankave të caktuara. Norma mesatare e ponderuar e kredisë në lekë në korrik regjistroi shifrën 13.33 për qind ose 0.74 pikë përqindjeje më lart se në muajin qershor.

Tabelë 11. Ndryshimi i interesave në tregje.

	Gusht -05	Ndryshimi vjetor gusht 05-gusht 04	Ndryshimi mujor gusht 05-korrik 05
Yield-i i b. të thesorit 3-mujore	5.73	- 1.07	+ 0.57
Yield-i i b. të thesorit 6-mujore	7.94	- 0.06	+ 1.35
Yield-i i b. të thesorit 12-mujore	8.41	- 0.49	+ 1.44
Yield-i obligacioneve 2-vjeçore	8.10	- 2.00	+ 0.40
Tregu ndërbankor 1-ditor	5.79	+ 2.85	+ 1.99
Tregu ndërbankor 7-ditor	5.61	- 0.09	+ 0.77

Ndryshimi i kahut të sjelljes së normave të interesit në lekë, ka filluar të pasqyrohet dhe në tendencën e *spread*-it midis interesave të depozitave në lekë dhe në valutë. Tashmë po vërehen shenja të zgjerimit të *spread*-it midis këtyre interesave, ndryshe nga tendenca e mëparshme rënëse, e cila zgjati më tepër se dy vjet.


Grafik 16. Ndryshimi real midis interesit të depozitave në lekë me ato në valutë (12-mujore).



Gjatë muajit korrik interesat e depozitave në valutë janë rritur thujse në të gjitha afatet, me përjashtim të interesave të depozitave 1 dhe 12-mujore në euro. Në rritjen e interesave në valutë, kanë ndikuar rritja e interesave libor dhe euribor, politika shtrënguese e ndjekur nga Fed-i, si dhe rritja e konkurrencës në tregun valutor. Shtrëngimi i mëtejshëm i politikës monetare nga Fed-i, në muajin shtator¹², pritet të ndikojë në rritjen e interesave libor në tregjet ndërkombëtare dhe në rritjen e interesave të depozitave dhe të kredive në usd.

¹² Në 21 shtator 2005 Fed-i rriti normën bazë të interesit me 0.25 për qind.

Grafik 17. Ecuria e normave të interesit në valutë.




Në muajin korrik, interesat e kredive në usd dhe në euro janë rritur në të gjitha afatet, me përjashtim të interesave të kredive me afat deri në 6 muaj. Norma mesatare e ponderuar e kredive në valutë për të gjitha afatet, ka rezultuar përkatësisht 8.56 për qind për kreditë në usd dhe 7.15 për qind për kreditë në euro, me një rritje prej 0.46 për qind për kreditë në usd dhe 1.52 për qind për kreditë në euro. Rritja e interesave të kredive në valutë është ndikuar nga rritja e interesave të depozitave në valutë, si dhe nga ndryshimi i strukturës së kredidhënies nga njëri muaj në tjetrin etj..

III.4 Kursi i këmbimit

Në pjesën më të madhe të nëntëmuajorit të parë të vitit, leku ka patur tendenca mbiçmuese kundrejt euros dhe usd. Megjithatë, ritmet e mbiçmimit të lekut kanë ardhur në rënie, sidomos krahasuar me dy vite më parë. Ndryshe nga vitet e tjera nuk është ndjerë efekti sezonal i muajve të verës, që rezultonte në mbiçmim të fortë të lekut kundrejt valutave kryesore. Në këmbimin ndaj euros, leku ka vazhduar të ecë në ritme të njëjta të mbiçmimit, të vëna re që në fillimin e vitit. Ndryshe ka ndodhur me këmbimin e lekut kundrejt dollarit ku është vënë re një mbiçmim i dollarit për pjesën më të madhe të muajit korrik. Gjatë muajit gusht, leku është pozicionuar në kahun e monedhës nënçmuese. Kjo situatë është ndikuar nga ecuria e turizmit brenda dhe jashtë Shqipërisë, ku efekti neto duket të jetë në favor të rritjes së kërkesës për valutë të huaj. Gjithashtu, edhe situata para dhe pas zgjedhore duket të ketë ndikuar sjelljen e publikut dhe vendimet e tij për mbajtjen e valutave.

Parë në një këndvështrim më afatgjatë, duket se ngushtimi i vazhdueshëm i diferencës së normave të interesit në lekë dhe në valutë, nuk përbën më një mbështetës për mbiçmimin e lekut. Në fund të muajit gusht, ndryshimi vjetor i kursit të këmbimit të lekut kundrejt euros është mbiçmim i lekut me 2.4 për qind dhe kundrejt dollarit një mbiçmim prej 3.3 për qind. Nivelet e tregimit të lekut në fund të gushtit shënojnë 123.15 lek/euro dhe 100.8 lek/usd.

Grafik 18. Ndryshimet vjetore të kursit të këmbimit të lekut.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

NR.78, DATË 12.10.2005

**PËR
" MIRATIMIN E PËRMBAJTJES DHE KONFIGURIMEVE TË VIZATIMEVE TË
MONEDHËS QË DO TË SHTYPET PËR QËLLIME NUMIZMATIKE NË VITIN
2006"**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" neni 33, pika 3 dhe neni 43, gërma d, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Emisionit,

V E N D O S I :

1. Pika 1.1 e vendimit nr. 27, datë 30.03.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, ndryshohet si më poshtë vijon;
 - 1.1. Monedhë metalike, prerja 50 (pesëdhjetë) Lekë , me tematikë "Kodiku i purpurtë i Beratit 043 Ö - Beratinus - 1" , pa kurs ligjor, me këto të dhëna teknike;
 - Vlera emërore 50 Lekë
 - Materiali Argjend, Ar
 - Pastërtia 925 / 1000
 - Ngjyrosje të purpurtë
 - Peshë 90 gr
 - Diametri 60 mm
 - Forma me vijë në mes
 - Tirazhi 1.000 (njëmijë) copë
2. Të miratojë konfigurimet e vizatimeve të monedhës metalike me vlerë emërore "50 Lekë", me tematikë "Kodiku i Purpurtë i Beratit 043 Ö - Beratinus 1" që do të shtypet për qëllime numizmatike (përkujtimore) në vitin 2006, sipas vizatimeve bashkëlidhur këtij vendim dhe me pamjet si vijon :
 - a Në pamjen e përparme, monedha ka të shkruar vlerën "50 Lekë" dhe shkrimin

“Kodiku i Purpurtë i Beratit 043 - Beratinus –1” i rrethuar me dy Ö. Në qendër të monedhës ka rrathë të përsëritur dhe të mbishkruar vlerën emërore “ 50 Lekë”, me gërma të marra nga kodiku. Mbi numrin 5 është vendosur emblema e UNESCO-s “Memorie Du Monde”.

- b Në pamjen pas, monedha ka të shkruar në hark sipër “Shqipëria – Albania” dhe në hark poshtë vitin “2006”. Harku i monedhës ka rrathë të përsëritur. Në qendër është vendosur një detaj nga Kodiku i zmadhuar, i cili ngrihet në relief me gërma argjendi dhe dy gërma në ar, mbi një sfond të purpurt.”
- 3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit për zbatimin e këtij vendimi.
- 4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
- 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI
YLLI MEMISHA**

**KRYETARI
ARDIAN FULLANI**

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 1, Shkurt 2005

1. Vendim nr.01, datë 26.01.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2004".
2. Vendim nr.02, datë 26.01.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri".
3. Vendim nr.03, datë 26.01.2005 "Për një ndryshim në rregulloren "Për dhënien e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë"".
4. Vendim nr.04, datë 26.01.2005 "Për caktimin e afateve të plotësimit të kërkesës për rritjen e kapitalit të kërkuar të bankave".
5. Vendim nr.08, datë 26.01.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun në Bankën e Shqipërisë".
6. Vendim nr.09, datë 26.01.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike të Bankës së Shqipërisë".
7. Vendim nr.10, datë 26.01.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Logjistike të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 2, Shkurt 2005

1. Vendim nr.11, datë 09.02.2005 "Për miratimin e dokumentit për misionin e mbikëqyrjes".
2. Vendim nr.12, datë 09.02.2005 "Për dhënien e miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, të bankës së propozuar "Union Bank" sh.a.".
3. Vendim nr.13, datë 09.02.2005 "Për miratimin e kontratës - tip për marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të letrave me vlerë".
4. Vendim nr.14, datë 09.02.2005 "Për miratimin e rregullores për dhënien e kredive për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 3, Shkurt 2005

1. Vendim nr.15, datë 23.02.2005 "Për miratimin e Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2005".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 4, Prill 2005

1. Vendim nr.18, datë 09.03.2005 "Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhave përkujtimore, që do të shtypen për qëllime numizmatike, në vitin 2005".
2. Vendim nr.19, datë 09.03.2005 "Për mënyrën e vlerësimit të vlerave numizmatike pa kosto në Bankën e Shqipërisë".
3. Vendim nr.22, datë 09.03.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 5, Prill 2005

1. Vendim nr.24, datë 30.03.2005 "Për uljen e përqindjes së interesave të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim nr.27, datë 30.03.2005 "Për shtypjen e monedhave për qëllime numizmatike, për vitin 2006".
3. Vendim nr.28, datë 30.03.2005 "Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 6, Maj 2005

1. Vendim nr. 30, datë 27.04.2005 "Për miratimin e raportit të politikës monetare për muajin mars të vitit 2005".
2. Vendim nr. 31, datë 27.04.2005 "Për një ndryshim në rregulloren për normat e mbikëqyrjes së subjekteve jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare".
3. Vendim nr. 32, datë 27.04.2005 "Për miratimin e sistemit raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare".
4. Vendim nr. 33, datë 27.04.2005 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 25, datë 01.04.2003 për miratimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003".
5. Vendim nr. 35, datë 27.04.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat dhe shpenzimet e daljes jashtë shtetit për shërbim, kualifikim etj., të punonjësve dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 7, Maj 2005

1. Vendim nr. 36, datë 19.05.2005 "Për miratimin e udhëzimit mbi procedurat e shtypjes, rishtypjes dhe të emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike nga Banka e Shqipërisë".
2. Vendim nr. 38, datë 19.05.2005 "Për miratimin e rregullores mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore".
3. Vendim nr. 40, datë 19.05.2005 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave në Bankën e Shqipërisë".
4. Vendim nr. 41, datë 19.05.2005 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave të Bankës së Shqipërisë".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 8, Qershor 2005

1. Vendim nr. 42, datë 08.06.2005 "Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen e ekonomisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2005".
2. Vendim nr. 43, datë 08.06.2005 "Për miratimin e rregullores për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim - kreditit dhe unioneve të tyre".
3. Vendim nr. 44, datë 08.06.2005 "Për miratimin e sistemit raportues për shoqëritë e kursim - kreditit dhe të unioneve të tyre".
4. Vendim nr. 45, datë 08.06.2005 "Për disa ndryshime në udhëzimin për kapitalin rregullator të Bankës së Shqipërisë".
5. Vendim nr. 46, datë 08.06.2005 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren për mjaftueshmërinë e kapitalit".
6. Vendim nr. 47, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga fondet për rindërtimin e Kosovës tek Fonds der Republik der Kosova, Gjermani".
7. Vendim nr. 48, datë 13.06.2005 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Dardania sh.a. nga Fonds der Republik der Kosova, Gjermani tek Francesco Mariano Mariano dhe Banca Popolare Pugliese (Banka Popullore Pulieze)".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 9, Qershor 2005

1. Vendim nr. 49, datë 29.06.2005 "Për miratimin e "Raportit të Politikës Monetare për muajin maj të vitit 2005".
2. Vendim nr. 51, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e

- sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)'''.
3. Vendim nr. 52, datë 29.06.2005 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për funksionimin e sistemit të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH'''.
 4. Vendim nr. 53, datë 29.06.2005 "Për "miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH'''.
 5. Vendim nr. 54, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat dhe procedurat e sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS'''.
 6. Vendim nr. 55, datë 29.06.2005 "Për disa ndryshime në "Rregullat e brendshëm të funksionimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 10, Korrik 2005

1. Vendim nr. 56, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Mbi transaksionet e shitbjeve me të drejta të plota'''.
2. Vendim nr. 57, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë Lombard'''.
3. Vendim nr.58, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për depozitën njëditore'''.
4. Vendim nr. 59, datë 13.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për kredinë njëditore'''.
5. Vendim nr. 60, datë 13.07.2005 "Për vendosje komisioni në sportelet e Bankës së Shqipërisë për bonot e thesarit''.

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 11, Gusht 2005

1. Vendim nr.66, datë 28.07.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi zhvillimet ekonomike dhe monetare për gjashtëmuorin e parë të vitit 2005".
2. Vendim nr. 67, datë 28.07.2005 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri".
3. Vendim nr.68, datë 28.07.2005 "Për miratimin e rregullores "Për mbikëqyrjen e konsoliduar".

Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 7, Numër 12, Shtator 2005

1. Vendim nr.70, datë 31.08.2005 "Për miratimin e raportit të Politikës Monetare për muajin korrik të vitit 2005".
2. Vendim nr. 71, datë 31.08.2005 "Për miratimin e udhëzimit "Mbi mënyrën e llogaritjes së "fiksit" të kursit të këmbimit të lekut, në Bankën e Shqipërisë".

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558
www.bankofalbania.org
E-mail: public@bankofalbania.org
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 320 kopje